



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Gjakovës**  
Opština Đakovica-Municipality of Gjakova



Numër 112/02-5787

Komuna e Gjakovës, grupi punues për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-11191 mbi Plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në Territorin e Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 68 (paragrafi 68.3) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, nenin 65 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 14 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, me datën 14.03.2022, publikon këtë:

### **N J O F T I M**

Grupi punues organizon konsultim publik me qytetaret e Komunës së Gjakovës dhe personat tjerë të interesuar lidhur me draft Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-11191 mbi Plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në Territorin e Komunës së Gjakovës.

Qytetare të nderuar të Komunës së Gjakovës është në interesin e juaj që të merrni pjese në këtë takim dhe të kontribuoni që kjo rregullore në draftin final të saj të jetë edhe me praktike edhe me profesionale.

Kopja fizike e draft Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-11191 mbi Plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në Territorin e Komunës së Gjakovës, mund të sigurohet në zyrën informative për qytetaret në objektin e Komunës së Gjakovës çdo dite pune prej orës 10:00 deri në ora 14:00, duke filluar nga data 14.03.2022, si dhe në ueb faqen e Komunës së Gjakovës:

<https://kk.rks-gov.net/gjakove/kuvendi/draft-rregulloret/>

Takimi publik mbahet me datën 15.04.2022 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës (ish ndërtesa e Bankosit), me fillim në ora 09:00.

Vërejtjet apo sugjerimet tuaja lidhur me këtë draft rregullore mund ti drejtohen komisionit drejtpërdrejt në konsultim apo me shkrim përmes e-mailit artan.hoxha@rks-gov.net.

Artan Hoxha  
  
Kryesues i grupit punues

